



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe të nenit 34.2 shkronja a të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2012, miratoi këtë:

VENDIM

PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK TË PROPOZIM RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

Neni 1

Vihet në diskutim publik propozim:

Propozim

- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregulloreve për taksa, tarifa dhe gjoba komunale

Neni 2

Diskutimi publik zgjatë 15 ditë dhe mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ditën e enjte më 5 dhjetor 2012, në orën 11.00.

Neni 3

Vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet paraqiten ditën e mbajtjes të diskutimit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën e Informimit, ndërtesa e Komunës zyra nr. 32.

Neni 4

Propozimet e Rregulloreve, sipas nenit 1 të këtij vendimi, publikohen në Web faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, ndërsa në formë të shkruar qytetarët, shoqatat joqeveritare, grupet e interesit dhe të gjithë të interesuarit të tjerë mund t'i marrin në Zyrën e Informimit e cila njëkohësisht është e obliguar të bëjë njoftimet e nevojshme përmes mjeteve të informimit.

Neni 5

Nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës, diskutimin publik e zbaton Planifikimi dhe Zhvillimit Ekonomik e cila është e obliguar të bëjë vlerësimin e propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktet e propozuara, të jap sqarime për arsyeshmërinë për pranimin apo mospranimin e propozimeve dhe sugjerimeve konkrete dhe për çështjet e ndryshuara të aktit të propozuar mbi bazën e diskutimit publik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 01/218 - 02
Podujevë,
23 nëntor 2012

Kryesuesi i Kuvendit
Hazir Raçi